



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr- 111-10618
ME DATE 13.02.2020

SH P A L L J E P U B L I K E

Për Kontrata për punë dhe detyra specifike (Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në nenin 8, dhe nenin 10 paragrafi 6,7 dhe 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, si dhe bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë, Drejtorisë për Bujqësi,Zhvillim Rural dhe Pylltari dhe Drejtoria për Administratë me qëllim të Kryerjes se punëve në këto Drejtori përmes; Kontratave për punë dhe detyra specifike kërkon angazhimin e 4(katër) zjarrfikës Shpetues dhe Një zjarrfikës vozitës dhe 2(dy) Roje Pylli si dhe pesë(5)sigurim fizik të objekteve të Komunës për ofrimin e shërbimeve për nevojat e këtyre Drejtorive.

I. Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë kërkon angazhimin e

Katër (4) zjarrfikës-Shpetues

Një zjarrfikës vozitës të kategorisë "C" për nevojat e kësaj Drejtorie.

Kohëzgjatja e Kontratave do të jetë 120 ditë (4) muaj

Paga: Bruto 400 Euro për zjarrfikës Shpetues, 450 Euro për zjarrfikës vozitës

Kualifikimi: Diplomë e shkollës së mesme

Diplomë e shkollës së mesme si dhe patentshoferi i kategorisë "C"

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbeshtetes gjatë intervenimit në zjarre dhe intervenimeve tjera te ndryshme
- Kujdestaron me ekipin dhe qdo here është në gjendje gadishmerie në orar te punës dhe jashtë orarit të punës kur është nevoja.
- Punon me ndërrime dhe bartë uniformën e punës.
- Kryejnë edhe punë të tjera sipas kërkesës së eprorit

II. Drejtoria për Bujqësi,Zhvillim Rural dhe Pylltari kërkon angazhimin e Dy (2) Roje pylli

Kohëzgjatja e Kontratave do të jetë 120 ditë (4) muaj

Paga: 350 Euro Bruto

Kualifikimi: Diplomë e shkollës së mesme

Detyrat dhe përgjegjësitë

- 1-Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga demtuesit ilegal
 - 2-Benë fletparaqitjen të prerjes ilegale,nxjerrjes,grumbullimit dhe perpunimit të masës drunore.
 - 3-Ruajtja e pyjeve publike dhe private nga zjarret,demtuesit dhe semundjet me origjinë fitopatologjike dhe etomologjike.
 - 4-Të ruaj dhe të përkujdeset përmbajtjen e shenjave të kufujëve të jashtëm dhe të mbrendshëm të pyjeve si dhe të informoj për uzurpimin e tokave pyjore.
- Të parandaloj gjuetin ilegale,pëckujdesja dhe mbrojtja e kafsheve të egra

Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:

- Aftësi të mira komunikimi
- Njohuri të punës në intervenime të ndryshme dhe
- Njohuri në fushën e zjarrfikjes dhe shpëtimit



III.Drejtoria për Administratë: Pesë (5) Sigurim fizik të objekteve të Komunës (Rojtar)-

Kohëzgjatja e kontratës 120 (njëqind e njëzetë) ditë (4) muaj.

Paga: 280 Euro Bruto

Kualifikimi : Shkolla e mesme

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.Bëni sigurimin fizik të godinave dhe hapsirave (oborrit) te Komunë
- 2.Pret dhe informon vizitorët e Komunës pas orarit të punës
3. Ndalon hyrjen e personave të pa autorizuar dhe te pa deshiruar;
4. Bëni mirëmbajtjen,kontrollin,pastrimin e oborrit nga mbeturinat,ujiit kopshtet barin,kontrollon dritat dhe merr masat per mbrojtjen e objekteve nga fatkeqësitë natyrore (uji,zjarri etj)
5. Kryen punë të tjera shtesë me kërkesë të shefit -Drejtorit.

Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:

- Të jete person me integritet te larte personal dhe moral;
- Aftësi të mira komunikimi ;
- Njohuri të mira të punës;

Mënyra e aplikimit:

Kandidatet e interesuar duhet te paraqesin një biografi profesionale (CV), certifikaten qe ndaj tij-saj nuk jane duke u zhvilluar hetimet,kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata te cilet nuk hyjn ne perzgjedhje nuk do te kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë , duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi te barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.



Kryetari i Komunës

Bali Muharremaj

